



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2024:079231

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05472084

P.nr.16/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona Lajqi, në çështjen penale ndaj të pandehurit: M. J. për shkak të veprës penale: Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2234/23 të datës 11.03.2024 dhe kërkesës për shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës, me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2234/23 të datës 11.03.2024 dhe kjo Gjykatë konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

M. J. nga babai Zh. dhe nëna R., e vajzërisë J., i lindur më ..., në Mitrovicë, me vendbanim në fshatin M., Komuna Leposaviq, beqar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes se dobët ekonomike, me numër personal ... dhe ..., serb, Shtetas i Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 21.12.2023, rreth orës 11:15, në fshatin Koshuticë, Komuna Leposaviq, i pandehuri me dashje tenton të kalojë vijën kufitare Republikë e Kosovës - Republikë e Serbisë, në vendkalimin e paautorizuar kufitar, në atë mënyrë që me automjetin e tij të markës “VW Sharan”, me ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., është zënë afër vijës kufitare.

-Me këtë ka kryer veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare në tentativë nga neni 140 par. 1 lidhur me nenin 28 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës

Andaj, gjykata në bazë të neneve 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69 dhe 140 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 449, 452 dhe 495 të KPPK-së:

GJYKON

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 250 € (*dyqind e pesëdhjetë euro*), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjkata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t`ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke i llogaritur për çdo 20 € (njëzet euro) gjobë me një (1) ditë burgim.
- II. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej njëzet (20) euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2234/23 të datës 11.03.2024, kundër të pandehurit M. J. për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga Gjykata ka kërkuar dhënien e Urdhrit Ndëshkimor-Dënim me gjobë, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPPK-së, që të pranohet kërkesa për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe në përputhje me nenin 495 të KPPK-së të jepet aktgjykimi pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së me të cilën akuzohet i pandehuri, ligjvënësi ka parashikuar dënimin me dyqind e pesëdhjetë (250) Euro gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK).

Gjykata, konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti i policit A. M. #6659, me numër 2023-YNC-101, i datës 21.12.2023, Raporti i informues i togerit I. Xh., i datës 21.12.2023, Tri fotografi të automjetit, Forma e pranimit – dorëzimit të rastit në Doganën e Kosovës – ZBD Mitrovicë, e datës 22.12.2023, Informacionet të marra nga Sistemi për menaxhimin e kufirit për të pandehurin dhe automjetin, Informacionet për të kaluarën kriminale të të pandehurit të marra nga data baza e Policisë së Kosovës, si dhe, Procesverbali mbi intervistimin e të pandehurit M. J. në SPMK Leposaviq, i datës 21.12.2023. i dhe shkresat e tjera të lëndës, janë prova të mjaftueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se në veprimet e të pandehurit manifestohen elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë.

Nga raporti i oficerit A. M., i datës 21.12.2023, vërtetohet se atë ditë rreth orës 11:05, në rrugën Postenje - Koshuticë, njësia e SPMK Leposaviq e kishin ndaluar një veturë të tipit “VW Sharan”,

me targa ..., cilën e drejtonte i pandehuri M. J. dhe gjatë kontrollit në veturë kishte pasur rreth 30 pako birrave të ndryshme, i njëjti kishte pohuar se këto paketime i kishte blerë nëpër qytet dhe më pas ishte nisur përmes rrugëve ilegale në Rashkë për t'i shitur.

Nga informacionet të marra nga Sistemi për menaxhimin e kufirit për të pandehurit dhe automjetin në fjalë, rezulton se i pandehuri dhe automjeti i tij kanë të regjistruara hyrje nga territori i Republikës së Kosovës por pa dalje dhe anasjelltas, fakt që vërteton se i njëjti është i njohur në kryerjen e veprës së njëjtë penale.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, konform nenit 69 të KPRK-së, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, duke konsideruar se dënimi i shqiptuar është dënim i drejtë dhe i ligjshëm dhe është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale meqë rast vepra penale është kryer me dashje nga ana e të pandehurit dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Andaj, gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i pandehuri do të përmbahet nga veprime të paligjshme në të ardhmen.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 lidhur me par.1 dhe nenit 452 par. 1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati, ngase sipas aktakuzës nuk kishte të propozuar palë të dëmtuar.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Dega në Leposaviq

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.16/2024, datë 19.03.2024

G j y q t a r j a,
Marigona LAJQI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të drejtë të paraqesin kundërshtim, në afat prej 8 (tetë) ditëve, nga dita e pranimet të tij. Kundërshtimi i parashtrohet kësaj Gjykate.